

V E N D I M
Nr. 4, datë 17.2.2003

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Zija Vuci	Anëtar i “ “
Gjergj Sauli	Anëtar i “ “
Alfred Karamuço	Anëtar i “ “
Kristofor Peçi	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Petrit Plloçi	Anëtar i “ ”
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “

me sekretare Arbenka Lalica, në datë 29.1.2003, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.255/10 Akti që i përket:

KËRKUES:

1. AVOKATI I POPULLIT
 2. SHOQATA E NDERTUESVE TË SHQIPËRISË, në mungesë.
- SUBJEKTE TË INTERESUARA:**

1. KËSHILLI I MINISTRAVE, në mungesë.
2. MINISTRIA E RREGULLIMIT TË TERRITORIT DHE TURIZMIT, në mungesë.
3. SHOQËRIA “EUROVINI” SH.P.K, përfaqësuar nga avokat Fatmir Braka.

OBJEKTI: Shfuqizimin si antikushtetues i vendimit nr 441, datë 26.9.2002 të Këshillit të Ministrave “Për ndalimin e menjëhershëm të veprimtarisë së shfrytëzimit të rërës dhe zhavorrit në shtretërit e lumenjve”.

Kërkuesit, nëpërmjet një kërkesë të përbashkët, pretendojnë se vendimi i sipërcituar i Këshillit të Ministrave është antikushtetues dhe parashtrijnë këto shkaqe për shfuqizimin e tij:

Së pari, ndalimi pa kufizim i veprimtarisë së shfrytëzimit të rërës dhe zhavorrit në shtretërit e lumenjve penalizon pa të drejtë të gjithë subjektet pa dallim dhe shkel nenet 11 dhe 44/1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

Së dyti, kufizimi i veprimtarisë ekonomike të këtyre subjekteve është bërë me Vendim të Këshillit të Ministrave dhe jo me ligj, siç përcaktohet në nenin 11/3 të Kushtetutës.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes Sokol Sadushin, Avokatin e Popullit, përfaqësuesin e subjektit të interesuar dhe pasi e analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Në seancë gjyqësore, Avokati i Popullit hoqi dorë nga gjykimi i kërkesës me arsyetimin se Këshilli i Ministrave, gjatë kohës që çështja ishte paraqitur për shqyrtim në këtë gjykatë, ka nxjerrë një vendim nëpërmjet të cilit ndryshon pikat 1 dhe 2 të Vendimit objekt kërkesë. Me kërkesën e Avokatit të Popullit u bashkua dhe përfaqësuesi i subjektit të interesuar, Shoqëria “EUROVINI” SH.P.K.

Shoqata e Ndërtuesve të Shqipërisë, e cila është në pozitën e kërkuesit në këtë çështje, nuk është paraqitur në të dy seancat gjyqësore që janë zhvilluar pranë Gjykatës Kushtetuese.

Në këto kushte, përderisa Avokati i Popullit hoqi dorë nga shqyrtimi i mëtejshëm i kësaj çështjeje dhe Shoqata e Ndërtuesve të Shqipërisë, megjithëse vërtetohet se ka marrë dijeni rregullisht për datat e zhvillimit të seancave gjyqësore dhe nuk është paraqitur në gjykim, pa shkak të arsyeshëm,

Gjykata Kushtetuese çmon se çështja duhet të pushohet.

PËR KETO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenet 131 e 132 të Kushtetutës si dhe në nenet 1 pika 2 e 72 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

V E N D O S I:

- Pushimin e gjykimit të çështjes.
- Ky vendim është i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.